



PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT
KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

DISKUTIM LIDHUR ME KALLOT, HUMBJET DHE DËMTIMET E PRODUKTEVE

Prishtinë, 7 nëntor 2025, 09:30 – 12:00

Takimi u moderua nga Drejtuesi i Sekretariatit Artan Mehmeti. Në takim morën pjesë 22 pjesëmarrës, që ishin përfaqësues të bizneseve vendore, anetare të Shoqatave PePeKo dhe Organika, Oda, fermer si dhe zyrtar institucioneve shtetërore në Kosovë.

Fjalët hyrëse

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI, në fjalën e tij hyrëse përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit që janë bashkuar këtij diskutimi të rëndësishëm për humbjet natyrore dhe dëmtimet e produkteve ushqimore për sektorin privat që është ngritë si temë edhe në forumet e kaluara. Vazhdoi tutje duke shpjeguar për rëndësinë e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI), që është një platformë e dialogut publik-privat që synon të afrojë institucionet publike me sektorin privat dhe të përmirësojë klimën investuese, qeverisjen dhe transparencën. Po ashtu theksoi se ky forum është organizuar nga Sekretariat i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në bashkëpunim me Shoqatën Organika dhe PePeKo.

Sekretariati mbështetet nga SECO përmes Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Theksoi se Sekretariati ka përgatitur një analizë të shkurtër krahasimore për të nisur diskutimin dhe synon, së bashku me sektorin privat, të hartojë një propozim para mbledhjes së Këshillit, me qëllim lehtësimin e vendimmarrjes së Ministrisë së Financave.

Faton Nagavci, Shoqata Organika

Theksoi se me mbështetjen e CARITAS-it zviceran dhe AKRC-së, ata kanë zhvilluar hulumtime për bazën ligjore dhe praktikën në vendet e rajonit, përmes ekspertit Naim Huruglica, ish-drejtor i Doganave. Vazhdoi tutje duke theksuar se nga hulumtimi rezulton se ligji aktual parasheh zgjidhje përmes një udhëzimi administrativ, i cili megjithatë nuk është nxjerrë prej vitesh, duke e lënë



çështjen të pazgjidhur dhe të varur nga interpretimet individuale të inspektorëve të ATK-së. Po ashtu tregoi se në: Shqipëri, kompanitë dorëzojnë normativat e humbjeve për miratim nga autoritetet përkatëse, kurse në Kroaci përdor lista të humbjeve të lejuara sipas sektorëve, të përcaktuara me përqindje fikse.

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI

Ztr. Mehmeti theksoi se çështja e humbjeve natyrore dhe dëmtimeve është e gjerë dhe prek sektorë të ndryshëm, me forma të ndryshme humblesh gjatë transportit, magazinimit apo prodhimit. Për këtë arsye, u sugjerua kategorizimi i llojeve të humbjeve për të arritur një analizë dhe propozim më të qartë për Këshillin dhe ministrinë relevante.

Vazhdoi tutje duke theksuar se, nëse udhëzimi administrativ nuk mjafton, mund të kërkohet edhe ndryshim ligjor. Deri më sot janë analizuar propozime nga Oda Ekonomike, Oda Amerikane dhe shoqatat e sektorit (Organika, PePeKo), si dhe praktikatat e vendeve të rajonit, ku Kroacia, Serbia dhe Bosnja kanë standarde të përcaktuara të humbjeve.

Analiza paraprake e Sekretariatit mbi të dhënat e importit dhe prodhimit (2024) tregon se vetëm për produktet ushqimore me humbje natyrore, vlera e importeve arrin rreth 853 milion euro, ndërsa humbjet e mundshme të llogaritura sipas modeleve krahasuese janë rreth 16–17 milion euro. Kërkoj mbledhjen e të dhënave shtesë për prodhimin vendor për të finalizuar analizën para prezantimit në Këshill.

- **Reagim, Faton Nagavci, Organika:** shembulli tregon se, nëse një biznes blen 10-ton portokaj, në fund të vitit mund t'i njihen deri në 3% si humbje natyrore, për të cilat nuk paguhen tatime.
- **Koment, Artan Mehmeti:** bazuar në standardet e Kroacisë, shumica e produkteve ushqimore kanë një përqindje të caktuar humblesh natyrore, e cila në rastin e Kosovës rezulton të jetë rreth 16–17 milion euro në vlerë për vitin 2024. Për produkte me humbje më të mëdha, si frutat me bërthamë (5,5%), mungesa e njohjes së humbjeve mund të pengojë nisjen e biznesit. Krahasoi praktikatat e Kroacisë dhe Sllovenisë, ku humbjet aplikohen sipas kategorive të produkteve dhe fazave të përpunimit.

Pyetje, Faton Nagavci, Shoqata Organika

Meqë Kroacia e Sllovenia janë shtete të BE-së, pyeti nëse ekziston ndonjë rregullore.

- **Përgjigje, Adnan Dema, Ekspert i Çështjeve Ekonomike:** ekziston një direktivë që trajton humbjet e produkteve, por lë vend për fleksibilitet për vendet e ndryshme në mënyrën e zbatimit. Edhe brenda vendeve të rajonit ka dallime, për shembull në Bullgari, ku humbjet



gjatë transportit të alkoolit varen nga mënyra e transportit (p.sh., përdorimi i drurit ose celikut) dhe normat e humbjeve përkatëse.

Bejtush Gashi, Euro Fruti

Theksoi se dëmtimet dokumentohen dhe mund të justifikohen përmes inspektimeve të Doganës, ndërsa humbjet shpesh nuk njihen nga ATK-ja. Tregoi se kompanitë e përpunimit të frutave kanë blerë lëndë të freskët (p.sh. dredhëza, mjedra, kumbulla) që gjatë transportit dhe procesimit kanë humbje natyrore, të cilat shpesh nuk janë regjistruar.

Faton Nagavci, Shoqata Organika

Ztr. Nagavci I drejtoi pyetje ztr. Gashi (Bejtush) për çështjen e 10 për qindshit?

- **Përgjigje, Bejtush Gashi, Euro Fruti:** prezenca e ekspertëve është e rëndësishme për të mbështetur propozimet ligjore dhe administrative, sepse në mungesë të një baze ligjore të qartë, inspektorët mund të penalizojnë kompanitë në mënyrë arbitrare, duke përfshirë llogaritjen e TVSH-së mbi humbjet e papaguara dhe çmimet e eksportit.
- **Pyetje, Artan Mehmeti:** pyeti nëse humbjet e produkteve duhet të jenë të standardizuara apo mjafton që të pranohet normativi.
- **Përgjigje, Bejtush Gashi, Euro Fruti:** është e rëndësishme njohja e humbjeve gjatë transportit, ngrirjes dhe përpunimit, të cilat mund të ndryshojnë sipas llojit të produktit dhe kushteve (p.sh., vera e thatë vs. e lagësht). ATK-ja ka njohur një normë të përgjithshme 10% për humbjet, por në praktikë humbjet reale mund të jenë më të larta.
- **Pyetje, Artan Mehmeti:** pyeti nëse duhet të ketë një standard për humbjet gjatë gjithë procesit të përpunimit të mjedrës, apo vetëm të regjistrohen humbjet si dallim hyrje-dalje në produkt
- **Përgjigje, Bejtush Gashi, Euro Fruti:** është nevoja për një standard të humbjeve për produktet e Kosovës që grumbullohen dhe përpunohen (mjedra, dredhëza, vishnje), duke përfshirë transportin, ngrirjen dhe procesimin. Po ashtu theksoi se humbjet ndryshojnë sipas produktit (p.sh., mjedra vs. kumbulla) dhe duhet të krijohet një ligj që përcakton norma të qarta për të gjitha produktet, duke shmangur vendime arbitrare nga inspektorët.

Aferdita Shabani, Administrata Tatimore e Kosovës

Znj. Shabani falënderoi Sekretariatit për zgjedhjen e temës dhe theksoi rëndësinë e diskutimit mbi trajtimin tatimor të humbjeve, dëmtimeve dhe kallove natyrore. Po ashtu sqari se:

- Humbjet e dokumentuara dhe të arsyeshme mund të njihen si shpenzime të zbritshme sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhura të Korporatave (nenet 9 dhe 10).



- Administrata Tatimore synon trajtim të drejtë, të barabartë dhe transparent për të gjithë tatimpaguesit.
- Sfida kryesore është se biznesi ka informacionin më të saktë mbi humbjet, ndërsa inspektorët duhet të vlerësojnë ato gjatë inspektimeve.
- Humbjet mund të shkojnë deri në gjykatë dhe ekspertët mund të angazhohen për vlerësimin.
- Ka nevojë për një normativ të përcaktuar për humbjet, si në vendet e rajonit dhe BE, që të shmangen zgjidhjet individuale dhe rastet e padrejta.

Për fund bëri thirrje për bashkëpunim midis sektorit privat dhe publik për të kontribuar në krijimin e këtij normativi.

- **Koment, Artan Mehmeti:** theksoi nevojën për të kuantifikuar inspektimet dhe kostot e humbjeve në gjykata, për të argumentuar se standardizimi sjell përfitime për ATK-në.

Bekim Kastrati, Dhoma Britanike e Tregtisë në Kosovë

Përgëzoi për iniciativën dhe veçoi kontributin e z. Huruglicës (fermer) për ekspertizën e tij në biznes, humbje, kontabilitet dhe procedurat doganore. Theksoi se:

- Qëllimi është të krijohet një ligj ose standard që të kënaqë biznesin dhe administratën tatimore, duke marrë parasysh situata reale dhe të paparashikueshme klimatike.
- Standardizimi i humbjeve do të lehtësojë procedurat për ATK-në dhe Doganën, duke reduktuar raste të mundshme gjyqësore dhe dëm të dytë për kompanitë.
- Duhet të dallohen humbjet reale nga keqpërdorimet, dhe të ketë mekanizma për të verifikuar dëshmitë për mallrat e prishura ose të papërshtatshme për shitje.
- Industria ushqimore dhe eksport-importi përballen shpesh me humbje gjatë transportit dhe përpunimit për shkak të kushteve klimatike, lagështisë ose faktorëve të tjerë që ndryshojnë peshën dhe cilësinë e produkteve.

Hartim Gashi, Shoqata PePeKo

Theksoi rëndësinë e vendosjes së normave fikse me ligj për humbjet, për të reduktuar subjektivitetin si nga ana e kompanive, ashtu edhe nga ana e inspektorëve të ATK-së. Po ashtu shtoi se norma fikse siguron parashikueshmëri, rrit efikasitetin e proceseve të brendshme dhe minimizon mosmarrëveshjet në terren.

Sqaroi se humbjet në substancë janë çështje e ndarë nga prishjet e produkteve. Në rast prishjeje, inspektoriat verifikon produktin, përpilohen procesverbale, dhe kompania lirohet nga detyrimi për shitje. Nuk kërkohet kompensim nga shteti për këto raste.



Fatmir Krasniqi, Fungo

Ztr. Krasniqi theksoi rëndësinë e partneritetit real mes shtetit dhe prodhuesve/eksportuesve. Theksoi se gjatë eksportit të kërpudhave të freskëta, vonesat nga institucionet (Dogana) shkaktojnë prishje të mallit. Importuesi i huaj kërkon *credit note* për humbjet, por ATK-ja nuk e pranon këtë si zbritje tatimore dhe krijon humbje të dyfishta për biznesin.

Bekim Kastrati, Dhoma Britanike e Tregtisë në Kosovë

Theksoi rëndësinë e vendosjes së një standardi ligjor që lehtëson punën e inspektorit tatimor/doganierit në verifikim dhe trajtimin e humbjeve të kompanive.

Hekuran Gashi, Drejtor i përgjithshëm i Politikave, Ministria e Financave

Theksoi nevojën për standardizim të njohjes së humbjeve, kallove dhe dëmtimeve në akte ligjore dhe nënligjore për të reduktuar subjektivitetin e inspektorëve të Doganës dhe ATK-së. Po ashtu theksoi se qëllimi është të krijohet një baza të dhënash unifikuese dhe e qartë që mund të shërbejë për legjislacion dhe politika të ardhshme.

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI

Z. Mehmeti theksosi rëndësinë e mbledhjes së të dhënave nga akterët relevantë për të krijuar një bazë informacioni të përbashkët që mund të prezantohet në Këshill për çka edhe synohet të mblidhen inpute nga ekspertët. Vazhdoi duke përmendur mundësinë e përdorimit të një survey për të plotësuar informacionin dhe krahasimin e të dhënave për efektivitetin fiskal.

- **Replikë, Bejtush Gashi, Euro Fruti:** të përdoret një normë fikse mesatare, bazuar në praktikën e vendeve si Kroacia, për të lehtësuar punën e ATK-së, doganave dhe bizneseve.
- **Reagim, Faton Nagavci, Organika:** duhet bashkëpunim më të afërt midis grupit dhe institucioneve, ku grupi të mbledhë informata nga terreni dhe t'ua ofrojë institucioneve për të pasur të dhëna reale.

Naim Huruglica, Fermer

Foli mbi humbjet e pakapshme (“untouchable”) në substance, si avullimi, tkurrja dhe tharja e produkteve gjatë transportit dhe magazinimit. Theksoi se humbjet ndodhin në faza të ndryshme: prodhim, përpunim, transport dhe tregti, dhe është e rëndësishme të dallohen fazat për të mbrojtur prodhuesit primarë. Po ashtu theksoi nevojën për standardizim për të lehtësuar punën e inspektorëve, për të shmangur subjektivitetin dhe mundësitë për abuzim, dhe për të inkurajuar investime teknologjike nga prodhuesit.



- **Reagim, Hartim Gashi, PePeKo:** humbjet e produkteve duhet të trajtohen nga prodhuesi deri tek tregtari, duke u njohur veç e veç për secilin aktor në zinxhirin e vlerës. U theksua se dy kërkesa kryesore për grupin punues janë:
 1. Të caktohen norma fikse për humbjet në substance për prodhuesit
 2. Të vendoset një standardizim i procesit të njohjes dhe verifikimit të humbjeve, të integruar ose në normative ose përmes një mekanizmi tjetër ligjor.
- **Kundëreagim, Artan Mehmeti:** ligjit aktual i mungojnë specifikime konkrete, pasi lë shumë çështje për t'u rregulluar më vonë përmes udhëzimeve administrative. Po ashtu përmendi se në vendet e rajonit, ligjet dhe rregullimet përfshijnë edhe sektorë të tjerë përveç bujqësisë, si kimikatet, pesticidet, detergjentët, produktet pastruese dhe materialet ndërtimore.

Sefedin Haxhia, Caritasi zviceran

Theksoi se Caritasi Zviceran ka punuar aktivisht me tre shoqata dhe disa akterë të tjerë për të mbështetur sektorin në rritjen e konkurrueshmërisë. Vazhdoi tutje se sjnë mbledhur të dhëna dhe është bërë analizë ligjore dhe brenda zinxhirëve të vlerës për frutat e imeta dhe bimët mjekësore. Po ashtu theksoi se qellimi është të ofrohet mbështetje teknike dhe informacion institucioneve për të mundësuar një akt nënligjor të qartë, duke vazhduar bashkëpunimin me shoqatat në dialogun publik-privat.

- **Reagim, Artan Mehmeti:** Sekretariati synon të diskutojë ligjet në faza të hershme me ministrinë për të mundësuar ndërhyrje më herët dhe për të arritur objektivat. Vlerësoi pozitivisht gatishmëria e sektorit privat për të dhënë inputet sa më shpejt.
- **Reagim, Hekuran Gashi:** ekziston nevoja që politikat tatimore të ndihmojnë tatimpaguesit pa krijuar incentive për evazion fiskal, duke përdorur standarde të qarta dhe evidence të dokumentuar. Po ashtu përmendi krijimin e një bordi gjithëpërfshirës për të siguruar efektivitet në dëgjimin e zërit të sektorit privat dhe për adresimin e ankesave.

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI

Theksoi çështjen e njohjes së humbjeve të frutave me bërthamë (p.sh. mollë) gjatë zinxhirit të furnizimit, duke theksuar situatën e rritjes së çmimeve. Pyeti nëse humbjet (p.sh. 3% për fazë) duhet të njihet veç e veç në çdo fazë të procesit (grumbullim, depo, shitje me pakicë) apo vetëm si humbje totale gjatë gjithë zinxhirit, për të pasur një evidencë të saktë dhe të drejtë.

- **Përgjigje, Naim Huruglica:** humbjet duhet të njihet nga secili subjekt në fazat e veta të deklarimit tatimor, pasi nuk prek secilin subjekt përtej zonës së përgjegjësisë së tij.



- **Reagim, Artan Mehmeti:** mosnjohja e humbjeve të materialeve rrit artificialisht çmimin e produkteve bazë për konsumatorin final, pasi kostoja e humbjeve nuk reflektohet në treg si në rajon ku këto humbje njihen dhe standardizohen. Kjo mund të ndikojë në konkurrueshmërinë dhe çmimet përfundimtare.
- **Replikë, Hekuran Gashi:** çështja është kryesisht procedural, bizneset duhet të kenë mundësi të regjistrojnë humbjet në vitin fiskal përkatës pa u penalizuar, në mënyrë që të mos rritet barrë administrative ose fiskale. Në të njëjtën kohë, humbjet ndikojnë edhe në planifikimin ekonomik të bizneseve dhe çmimet e tregut, por fokusi kryesor është trajtimi i drejtë procedural.
- **Reagim, Naim Huruglica:** problemi kryesor është njohja e vlerës reale të humbjeve: bizneset nuk duhet të penalizohen me tatim mbi mallin që nuk e kanë shitur. Të dhënat zyrtare (p.sh. nga ASK) shpesh tejkalojnë prodhimin real, duke krijuar diferenca që regjistrohen si shitje të brendshme dhe rrisin barrën tatimore për biznese. Vlera reale e prodhimit është më e ulët se sa raportimet zyrtare, kështu që humbjet duhet trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në të dhëna të sakta.

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI

Diskutimi përqendrohet tek nevoja për të kuantifikuar humbjet dhe ndikimin e tyre tek kompanitë dhe buxheti i shtetit. Kjo do t'i mundësojë Ministrisë të ketë një pamje të qartë të pasojave financiare dhe të vendosë më lehtë për përfshirjen e produkteve në listën e standardizuar

Reagim, Naim Huruglica: vuri në pah se “humbje për shtetin” nuk është i saktë dhe nuk duhet përdorur, pasi shumat për të cilat flitet nuk përbëjnë humbje reale të buxhetit. Diskutimi duhet të përqendrohet tek efekti tek biznesi dhe regjistrimi i korrektë i humbjeve të materialit, pa i interpretuar ato si humbje tatimore për shtetin.

Artan Mehmeti, Drejtues i KKEI

Theksoi rëndësinë që rregullimi të bëhet përmes udhëzimit administrativ, e jo me ligj, në mënyrë që ndryshimet të mund të bëhen më shpejt dhe sipas nevojës. Po ashtu theksoi se deri në takimin e radhës pritet të ketë materiale më të avancuara për t'u prezantuar si kërkesë e përbashkët.

Mbyllet takimi.